




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-1634/13</u>
Nr. l faq. Broj stranica Nr. pages <u>02</u>	Data Datum Date <u>31.05.2013</u>
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë **27.05.2013**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-464/13 për znj. Seniha Hajrullahu–Auditore e brendshme në Kompaninë Rajonale të ujit “Hidromorava” Gjilan, për shkak se është parandaluar situata e mundshme e konflikti të interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-464-13, për Zyrtaren e lartë, znj. Seniha Hajrullahu– Auditore e brendshme në Kompaninë Rajonale të ujit (K.R.U.) “Hidromorava” Gjilan, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-464/13, të dyshuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtarja e lartë, znj. Hajrullahi së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës zyrtarja është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë, me ç’rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë për të parandaluar situatën e mundshme të konflikti të interesit.

Zyrtarja e lartë. znj.Hajrullahu është deklaruar se do të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar i biznesit privat, në mënyrë që të vazhdoi të ushtroj funksionin e saj publik, pa konflikt të mundshëm të interesit.

Ndërkohë, pas këtij takimi, znj.Hajrullahu në Agjenci ka sjellur informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI-03-1491-13), në të cilën shihet se biznesi N.P.Sh. “Shërbime financiare dhe kontabilitet” në të cilin znj.Hajrullahu kishte funksion të personit të autorizuar tashmë është shuar në mënyrë vullnetare.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtore i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

